

VENDIM
Nr. 796, datë 28.12.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 326, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE
PUNONJËSVE TË TJERË TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË DISA
INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kreu 1/4, i vendimit nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, zëvendësohet me kreun nr. 1/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 prill 2023.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Kreu I/ 4

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të Prokurorisë së
Përgjithshme dhe të punonjësve të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe
Krimin të Organizuar**

Nr. rendor	Emërtimi i pozicionit	Klasa e pagës
1	Oficer informacioni dhe i ruajtjes së rendit; Oficer informacioni në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; Sekretar; Ndihmës (sekretari – protokoll); Punonjës i postës sekrete.	VII
2	Shofer drejtuesi në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; Teknik mirëmbajtjeje; Operator; Magazinier.	VI
3	Shofer i postës sekrete; Kuzhinier në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; Shofer prokurori në Prokurorinë e Posaçme.	V
4	Shoferë të tjerë të institucionit.	IV
5	Punonjës pastrimi.	II

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.